



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:293892
Datë: 28.06.2024
Numri i dokumentit: 05876261

KPPP.nr.2228/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbaremore të kreditorit Komuna e Obiliqit, me adresë në Rr. “Adem Jashari” Nr.2, kundër debitorit “BU MARKET” Sh.P.K., me adresë Rr. “Adem Jashari” pn, në Obiliq, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Fitim Gashi me seli të zyrës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbaremore P.nr.2809/23 i lejuar me datë 22.11.2023, nga Përmbareuesi Privat Flamur Bogaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 19.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

I REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “BU MARKET” Sh.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr.2809/23 të datës 22.11.2023, i lejuar nga Përmbareuesi Privat Flamur Bogaj, dhe i njejtë Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumentit përmbaremore, Aktvendimit nr.IV/57 të datës 10.02.2022, të nxjerrë nga Komuna e Obiliqit, ka lejuar Urdhrit Përmbaremore P.nr.2809/23, të datës 22.11.2023, me të cilin është urdhëruar debitori që në emër të përmbushjes së obligimeve, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit

të urdhrorit, t'ia paguaj shumën prej 4,320.00 Euro, dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Debitori, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin mbi lejimin e përmbartimit, për shkak se dokumenti në bazë të të cilit është marr urdhri nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbartueshmërisë, se ka skaduar afati kohor brenda të cilit mund të kërkohet përmbartimor, si dhe për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të LPP-së. Më tej ka theksuar se dokumenti në bazë të të cilit është lejuar përmbartimi është vetëm një faturë fiktive e lëshuar pa kurrfarë baze ligjore nga ana e kreditorit, e të cilën debitori nuk e ka pranuar dhe nënshkruar si dhe e njejta nuk është dokument i besueshëm siç kërkohet me nenin 29 par.1 nën par.1.3 të LPP-së. Ka shtuar se as dokumenti aktvendimi nr.IV/57 i datës 10.02.2022, i nxjerrë nga kreditori, nuk ka titull ekzekutiv, për faktin se vendimi në fjalë nuk i përmbush elementet thelbësore për të qenë dokument përmbartues, sepse i njejti nuk është i pajisur me klauzolën e plotfuqishmërisë e as të ekzekutueshmërisë siç kërkohet me nenin 36 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit, ndërsa të anulohet urdhri përmbartimor i Përmbartuesit Privat, si dhe të përfundohet procedura e përmbartimit. Debitori i ka kërkuar edhe shpenzimet e përpilimit të prapësimin sipas TOAK-së, si dhe shpenzimet tjera të procedurës së përmbartimit.

Kreditori, në përgjigje në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi argumentet e paraqitura nga debitori, sa i përket afatit të parashkrimit të borxhit, ngase në bazë të nenit 361 të LMD-së par.1 parashihet se “Të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë (10) vjet, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër për parashkrim”. Më tej ka theksuar se dokument i besueshëm është fatura e vitit 2023 e cila nuk konsiderohet e pasafatshme sepse ende jemi në vitin 2023, e cila faturë ka kalkuluar borxhet e saktësuara sipas aktvendimeve të theksuara në propozim dhe prapësim, andaj të njejtat poashtu janë tituj ekzekutiv. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar, ndërsa të vërtetohet urdhri për përmbartim i Përmbartuesit Privat, si dhe të detyrohet debitori të paguaj të gjitha shpenzimet sipas TOAK-së, në afatin e paraparë ligjor si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se

prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar, andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Me nenin 22 të LPP-së, në paragrafin 1 nënparagrafin 2 është përcaktuar se dokumente përmbaruese janë *“vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe ujdia...”*. Gjithashtu neni 23 paragrafi 2 i LPP-së ka përcaktuar se *“Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike...”*, kurse neni 24 paragrafi 3 i LPP-së ka paraparë se *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*.

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor, përkatësisht Aktvendimin e Komunës së Obiliqit nr.IV/57 të datës 10.02.2022, në bazë të së cilit Përmbaruesi Privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti se i njëjti, konform nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata gjeti se Aktvendimi nr.IV/57 i datës 10.02.2022, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, dhe shuma e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi nr.IV/57 i datës 10.02.2022, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri”*, dhe neni 24 paragrafi 3 i LPP-së sipas të cilit përcaktohet se *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*, ngase Aktvendimi nr.IV/57 i datës 10.02.2022, i nxjerrë nga

Komuna e Obiliqit, është dorëzuar në original, si dhe është bërë përmbarimor në bazë të rregullave me të cilat është rregulluar procedura administrative, ngase në pikën V të dispozitivit të Aktvendimit të lartcekur, është përcaktuar se “Ankesa e ushtruar ndaj këtij aktvendimi nuk e shtyen ekzekutimin e tij”.

Andaj, meqenëse në këtë çështje përmbarimore gjykata vlerëson përshtatshmërinë e dokumentit përmbarues sipas dispozitave të zbatuara ligjore, nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2228/23, më datë 19.06.2024

Gjyqtari,

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.